



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 238 prot.

Tiranë, më 03.02.2021

### V E N D I M

**Nr. 21, datë 03.02.2021**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 98, datë 18.09.2020, e shtetasit S. C., kundër Postës Shqiptare, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të aftësisë së kufizuar*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesi pretendon se më datë 24.08.2020, është paraqitur pranë Zyrës Postare Tiranë Nr. 15, për të marrë një mandat pagese. Kur ka mbërritur në këtë zyrë postare, ankuesi ka konstatuar faktin se mungon aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuar, duke i mohuar atij të drejtën për të marrë shërbimet e ofruara në mënyrë të lirë dhe të pavarur. Në këto kushte, i është drejtuar një punonjëseje të Zyrës Postare, duke i kërkuar ti ofronte shërbimin në ambjentet e jashtme të zyrës, duke qënë se ai e kishte të pamundur të aksesonte ambjentet e Zyrës Postare Nr. 15, në mungesë të rampës. Sipas ankuesit, punonjësja e Zyrës Postare, i është përgjigjur duke i thënë se nuk ka një urdhër të tillë për t’i shërbyer atij në ambjentet e jashtme të zyrës.

Në këtë kuptim, mungesa e aksesueshmërisë së Zyrës Postare Nr. 15, ka bërë që ankuesi të mos marrë shërbimin e nevojshëm si të gjithë qytetarët e tjerë, duke u vënë kështu në kushte të pabarabarta dhe diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese ndaj tij, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe të zbatohet legjislacioni sa i përket përshtatshmërisë.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore të miratuara me ligjin nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>1</sup>. Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të pandryshuar.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>2</sup>, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

<sup>1</sup> Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>3</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pas analizimit paraprak të ankesës Nr. 98, datë 21.09.2020, e shtetasit S. C., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1258/1 prot., datë 30.09.2020 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues<sup>4</sup> Postës Shqiptare sh.a., lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

- Në përgjigje përsa më sipër, Posta Shqiptare sh.a., me anë të shkresës<sup>5</sup> nr. 1967/1 prot., datë 14.10.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Në datën 24.08.2020, pranë Zyrës Postare nr.15, është paraqitur shtetësja znj. H. C., e cila ka kërkuar t’i kryhet shërbimi për Z.V.R.P.P DR Tirana Veri. Gjithashtu të njëjtin shërbim znj. H. C., e ka kryer dhe për djalin e saj, shtetasin S. C. Punonjësja e Zyrës Postare nr. 15, nuk ka dalë jashtë ambjenteve të Zyrës Postare, pasi ky shërbim kërkon plotësimin e një formulari dhe plotësimin e objektit postar me adresë marrësi dhe dërguesi, veprime, të cilat janë të pamundura të bëhen jashtë sportelit të Zyrës Postare. Për këtë arsye, formularin dhe objektin e ka plotësuar punonjësja e shërbimit duke marre të dhënat nga shoqëruesi i shtetasit të mësipërm. Pra pretendimi i S. C. se atij nuk i është ofruar shërbimi, nuk qëndron, pasi shërbimi është ofruar si për S. C. dhe për nënën e tij znj. H. C.

Lidhur me infrastrukturën, gjatë vitit 2018-2019, “Posta Shqiptare” ka kryer rikonstruksionin e shumicës së Zyrave Postare të Filialit të Postes Tiranë. Duke qënë se kjo Zyrë Postare është marrë me qira nga “Posta Shqiptare”, nuk mund të kryhen investime përfshi dhe vendosjen e rampave për personat me aftësi të kufizuara. Në këto kushte, është diskutuar me pronarin e këtij objekti në lidhje me këtë shqetësim. Pronari i godinës është treguar i gatshëm që të diskutojë me përfaqësuesit e Njesisë Administrative Nr. 14-të, në zonën Astirit për të mundësuar marrjen e lejes së ndërtimit për të ndërhyrë në pjesën e përparme të objektit. Aktualisht jemi në pritje të përgjigjes nga pronari i godinës.

Përsa i përket rregulloreve ose udhëzimeve, në lidhje me ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, “Posta Shqiptare” nuk disponon materiale të tilla.

- 
- <sup>4</sup> Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
  - Informacion nëse Zyra Postare Nr. 15, ka infrastrukturën e nevojshme për t’u aksesuar nga personat me aftësi të kufizuara. Nëse jo, si ofrohet shërbimi për personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të aksesojnë Zyrën Postare.
  - I Informacion dhe kopje të dokumentacionit, nëse ekziston ndonjë rregullore apo udhëzim për punonjësit e Postës Shqiptare, në ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.
  - Informacion nëse janë parashikuar investime nga ana e Postës Shqiptare, për të bërë të mundur aksesimin e Zyrës Postare Nr. 15, Tiranë, nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

<sup>5</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 954/2 prot., datë 03.08.2020

*Në investimet e programuara për Zyrat Postare është pasur në vëmendje krijimi i ambjenteve bashkëkohore me përshtatshmëri dhe për shtresat me aftësi të kufizuar, por duhet theksuar se duke qënë se Zyra Postare Nr. 15, është një ambient i marrë me qira, Shoqëria “Posta Shqiptare” nuk mund të ndërmarrë iniciativën për të kryer planifikime dhe realizime mbi rikonstruksionet e ndryshme që ajo zyrë ka nevojë. Siç është saktësuar edhe më lart, është komunikuar me pronarin e objektit për të mundësuar ndërhyrjet e nevojshme, dhe pronari është treguar i gatshëm që të diskutojë me përfaqësuesit e Njësisë Administrative Nr. 14-të në zonën e Astirit për të mundësuar marrjen e lejes së ndërtimit, për të ndërhyrë në pjesën e përparme të objektit.*

*Ju sqarojme gjithashtu se, në kuadër të strategjisë së “Posta Shqiptare” sh.a., për përmirësimin e vazhdueshëm të ambjenteve në të cilën kryhen shërbimet, Posta Shqiptare investon në rikonstruksionet e ambjenteve, ku një nga kriteret është dhe krijimi i aksesit për shërbimet ndaj personave me aftësi të kufizuar.”.*

Bashkëngjitur shkresës, Posta Shqiptare sh.a., vendosi në dispozicion të Komisionerit foto të realizuara të Zyrës Postare Nr. 15, ku konstatohej mungesa e rampës dhe kopje të mandateve të arkëtimit për shërbimin e marrë nga ana e S. C. dhe të nënës së tij.

2. Me anë të shkresës nr. 1620 prot., datë 23.11.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ju drejtua sërish Postës Shqiptare sh.a., duke i kërkuar informacion dhe kopje të dokumentacionit përkatës, rreth hapave të ndërmarrë me pronarin e godinës dhe përshtatjen e Zyrës Postare nr. 15, për personat me aftësi të kufizuara.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Posta Shqiptare sh.a., me anë të shkresës<sup>6</sup> nr. 2454/1 prot., datë 04.12.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...në datën 02.12.2020 është firmosur Proces-Verbali me nr. 1678 prot., mes z. F. H., me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, dhe znj. D. T., pronare e objektit, në të cilin mes palëve është dakordësuar që brenda muajit Dhjetor 2020 nga ana e znj. D. T. do të merren masat e menjëhershme për të ndërhyrë në pjesën e përparme të objektit, për vendosjen e një rampe, për të mundësuar në këtë mënyrë kryerjen e shërbimeve programeve postare të ofruara nga Zyra Postare Nr. 15, edhe për personat me aftësi të kufizuara...”

3. Përsa më sipër, Komisioneri me anë të e-mailit, datë 07.01.2021, i dërgoi subjektit ankues informacionin e shkëmbyer me Postën Shqiptare sh.a., lidhur me rampën e Zyrës Postare nr. 15 Tiranë. Në këtë kuptim, kërkoi gjithashtu nga ana e subjektit ankues nëse është realizuar dhe plotësuar objekti i ankesës së paraqitur pranë KMD-së. Gjithashtu, gjatë ditëve në vijim, Komisioneri ka provuar të kontaktojë nëpërmjet numrit telefonit, por nuk është bërë e mundur.

---

<sup>6</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1620/1 prot., datë 09.12.2020

Në vijim, pas kontaktit të marrë me Postën Shqiptare sh.a., më datë 01.02.2021, nga ana e tyre u përcoll pranë Komisionerit, foto gjatë dhe pas realizimit të rampës në pjesën e përparme të objektit të Zyrës Postare Nr. 15 Tiranë.

Neni 33, pika 9 e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*.

Komisioneri vlerëson frymën bashkëpunuese të Postës Shqiptare sh.a., lidhur me marrjen e masave për zgjidhjen me efektivitet të problematikës së paraqitur nga ana e shtetasit S. C.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesa e S. C., është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim.

Në përfundim, Komisioneri mbështetur në llojin dhe natyrën e shërbimeve që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a, shërbime të cilat kanë ndikim në jetën e personave me aftësi të kufizuara, siç janë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike, në vijim kërkon marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë në Zyrat Postare të saj në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Përsa më sipër, gjatë shqyrtimit të ankesës Nr. 77 regj, datë 20.07.2020, Komisioneri me vendimin Nr. 10, datë 21.01.2021, ka konstatuar diskriminimin e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër. Në referim të këtij konstatimi, brenda një afati prej 3 (tre) muajsh, nga dita e komunikimit të tij, Komisioneri ka urdhëruar që Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa për plotësimin e të gjitha standarteve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”* dhe nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*, në mënyrë të veçantë në lidhje me :

- Plotësimin e të gjitha standarteve teknike në lidhje me platformën e pjerrët/rampën, sipas parashikimeve në pikën 2.11, neni 8, Kreu I, të Pjesës së Dytë të Rregullores *“Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008.
- Plotësimin e të gjitha standarteve teknike të parashikuara në pikën 2.10, neni 8, Kreu I, të Pjesës së Dytë të Rregullores *“Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë

19.11.2008, në lidhje me fushën relievore paralajmëruese në pjesën e shkallëve, por jo vetëm.

- Plotësimin e të gjitha standarteve teknike në lidhje me vendosjen e vijave relievore drejtuese për të orientuar personat që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim, si dhe planin orientues për lëvizje në ndërtesë sipas parashikimeve në nenin 18, Kreu I, të Pjesës së Dytë të Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008.
- Plotësimin e të gjitha standarteve teknike të parashikuara në nenin 21, Kreu I, të Pjesës së Dytë të Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, në lidhje me sportelet e përshtatura për t’i shërbyer personave me aftësi të kufizuara.
- Trajnimin e stafit të shërbimit pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, i ka rekomanduar Postës Shqiptare sh.a. që brenda 6 (gjashtë) muajve të hartojë një plan masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Bazuar në parashikimet e pikës 10, të kreut I, të VKM-së nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe nenit 90, pika 2 dhe 3 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur, lidhur me shqyrtimin e ankesës së S. C., pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Aftësie kufizuar)  
(Fusha: Të mira dhe Shërbime)